



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 956 /2023

Datë: 30 nëntor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 11 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 30 nëntor 2023, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Z. Ilaz Beqiri, prokuror në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, avancohet në Prokurorinë e Apelit nga data 01 janar 2024.
- II. Z. Ilaz Beqiri ka të drejtë në beneficionet që dalin nga ushtrimi i detyrës së prokurorit në Prokurorinë e Apelit.
- III. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në Ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e mbajtur me datë 30 nëntor 2023 ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të Shtetit, KPK/KATPSH të datës 08 nëntor 2023, ku pas shqyrtimit të të njëjtit raport, Këshilli me shumicë të votave dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Ilaz Beqiri;
- Kryeprokurorëve PA dhe P. Th. Prishtinë;
- Sekretariatit të KPK-së;
- NJSHPP dhe Dosjes së Prokurorëve;
- Arkivot të KPK-së.